

Hani i Elezit përfiton nga projekti "LOGOS"
Zvicra i investon 40 mijë euro
në 2 shkolla të Hanit të Elezit



HANI I ELEZIT, 9 MAJ - Qeveria zvicerane i ka alokuar 40 mijë euro për dy projekte infrastrukturorë në Han të Elezit. "Projekti LOGOS i Qeverisë zvicerane, që zbatohet në 7 komuna të Kosovës, i ka alokuar 20 mijë euro për riparimin e kulmit të shkollës fillore 'Ilaz Thaçi' në Han të Elezit dhe po aq mjete do t'i investojë për instalimin e ngrohjes qendrore në shkollën fillore 'Kështjella e diturisë' në

fshatin Paldenicë", ka theksuar Bashkim Sopa, zëdhënës i Komunës së Hanit të Elezit, të hënën. Ai ka thënë se për realizimin e projekteve të sipërpërmendura Komuna do të participojë me rreth 18 mijë euro. "Këto dy projekte Komuna ia ka propozuar LOGOS-it për financim", ka theksuar zëdhënësi Sopa. Investimet e LOGOS-it në Han të Elezit janë vlerësuar të një rëndësie të veçantë për këtë komunë të vogël. "Këto investime i çmoj të një rëndësie të veçantë për faktin se buxheti i limituar i Komunës nuk është në gjendje t'i përmbushë nevojat e ngutshme të qytetarëve për investime në infrastrukturën fizike", ka theksuar Rufki Suma, kryetar i Komunës. Në këtë kontekst, ai ka nënvizuar se nuk është hera e parë që Hani i Elezit përfiton nga projekti LOGOS. "Vjet i ka investuar 9 mijë euro për shtrimin me kubëza betoni të një rrugice në Han të Elezit", ka rikujtuar ai.

E.R.